



Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.9/2017, datë 02.08.2017), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 58-të, të mbajtur më 23 korrik 2018, mori:

V E N D I M

1. Tërhiqet akreditimi i programeve të studimit të BPrAL Kolegjit "Biznesi", kampusi në Prishtinë:
 - Banka dhe Financa në Biznes, BA, 180 ECTS,
 - Menaxhment dhe Financa, MA, 120 ECTS,
 - Menaxhim I Emergjencave, MA, 120 ECTS, dhe
 - Juridik Penal, LLM, 60 ECTS.
2. Tërhiqet akreditimi i programeve të studimit të BPrAL Kolegjit "Biznesi", dega në Gjakovë:
 - Banka dhe Financa në Biznes, BA, 180 ECTS,
 - Menaxhimi i Emergjencave, BA, 180 ECTS, dhe
 - Juridik, LLB, 240 ECTS.
3. Tërhiqet akreditimi i programeve të studimit të BPrAL Kolegjit "Biznesi", dega në Vushtrri:
 - Banka dhe Financa në Biznes, BA, 180 ECTS,
 - Juridik, LLB, 240 ECTS, dega në Vushtrri, dhe
 - Menaxhment dhe Ekonomiks, BA, 180 ECTS.
4. Tërhiqet akreditimi i programit të studimit të BPrAL Kolegjit "Biznesi", dega në Prizren:
 - Menaxhimi i Emergjencave, BA, 180 ECTS.
5. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetimi

Bazuar në Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (tash e tutje UA për Akreditim), neni 21 dhe 26, pika 5.3.4, Agjencisë së Kosovës për Akreditim (tash e tutje AKA) me datë 23 maj 2018 ka kërkuar nga të gjitha Institucionet e Arsimit të Lartë (tash e tutje IAL) që ti dorëzojnë listat e stafit akademik për secilin program të studimit. Në afatin e përcaktuar nga AKA, Kolegji "Biznesi" ka dorëzuar listat e kërkuara nga AKA për programet e studimit.

Bazuar në të dhënat e prezantuara nga ky IAL, për programet e studimit: Banka dhe Financa në Biznes, BA, 180 ECTS, kampusi në Prishtinë, Banka dhe Financa në Biznes, BA, 180 ECTS, dega në Gjakovë, Menaxhimi i Emergjencave, BA, 180 ECTS, dega në Gjakovë, Juridik, LLB, 240 ECTS, dega në Gjakovë, Banka dhe Financa në Biznes, BA, 180 ECTS, dega në Vushtrri, Juridik, LLB, 240 ECTS, dega në Vushtrri, Menaxhment dhe Ekonomiks, BA, 180 ECTS, dega në Vushtrri, dhe Menaxhimi i Emergjencave, BA, 180 ECTS, dega në Prizren, (sipas kërkesës së AKA-së datë 23.05.2018) konfirmohet se për këto programe të studimit nuk ka asnjë staf akademik si bartës të programeve të cekura me lartë.

Sipas nenit 26, pika 5.3.4 kërkohet që: "Për programet e studimit të cilat shpijnë deri tek marrja e një diplome shkencore Bachelor dhe Master, kërkesat për stafin akademik janë që për çdo grup të studentëve (të përcaktuar sipas statutit të IAL) dhe për çdo 60 ECTS kredi të programit të studimit, institucioni duhet të ketë të paktën një (1) staf me marrëdhënie të rregullt të punës me titull PhD apo titull të barasvlershëm artistik nga fusha e programit të studimeve". Pra siç mund të shihet nga sa u tha me sipër, kërkohet që për çdo 60 ECTS, IAL duhet të ketë një person në marrëdhënie të rregullt të punës me gradën shkencore PhD dhe të jetë i fushës së programit të studimit.

Në mungesë të stafit akademik për programet e cekura me sipër, sipas nenit 26, pika 5.3.4 e UA për Akreditim, KSHC mori vendim për tërheqjen e akreditimit për këto programe.

Për programin e studimit: Menaxhment dhe Financa, MA, 120 ECTS, Kolegji "Biznesi", si bartës të këtij programi të studimit ka vendosur: Ariana Xhemajli, Florim Idrizi, dhe Isamedin Azizi. Sipas nenit 26, pika 5.3.4, të UA për Akreditim, për programet e studimit me 120 ECTS, duhet të jenë të paktën dy bartës të programit me gradën shkencore Dr.sc, dhe të jenë të fushës së studimit. Sipas të dhënave të prezantuara nga Kolegji "Biznesi", ky program i përket fushës së ekonomisë, por vetëm Ariana Xhemajli është e fushës së ekonomisë, ndërsa Florim Idrizi dhe Isamedin Azizi nuk janë të kësaj fushe. Florim Idrizi sipas të dhënave të prezantuara nga ky institucion i përket fushës së informatikës, ndërsa Isamedin Azizi i përket fushës së historisë. Bazuar në këto të dhëna, KSHC vlerësoi që fusha e studimit të këtyre bartësve nuk përkon me programin e studimit, andaj vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Për programin e studimit: Menaxhim i Emergjencave, MA, 120 ECTS, Kolegji "Biznesi" si bartës të këtij programi të studimit pa vendosur: Shefket Dehari dhe Xhelal Kepuska. Shefket Dehari sipas të dhënave të prezantuara nga ky institucion i përket fushës së kimisë, ndërsa Xhelal Kepuska i përket fushës së Bujqësia dhe Shkencave Mjedisore. Bazuar në këto të dhëna, KSHC vlerësoi që fusha e studimit të këtyre bartësve nuk përkon me programin e studimit, andaj vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Për programin e studimit: Juridik Penal, LLM, 60 ECTS, Kolegji "Biznesi" si bartës të këtij programi të studimit ka vendosur: Arsim Rexhepi dhe Hidajete Azizi. Pas kontrollimit të dokumentacionit relevant, u konstatua që Arsim Rexhepi është i fushës së filologjisë (Germanistikës), ndërsa Hidajete Azizi, i përket fushës së filologjisë, dhe rrjedhimisht asnjeri nga këta persona nuk mund të jetë bartës i këtij programi të studimit.

Sipas nenit 26, pika 5.3.4, të UA për Akreditim, për programet e studimit me 60 ECTS, duhet të jetë të paktën një bartës i programit të studimit me gradën shkencore Dr.sc, dhe të jenë të fushës së studimit.

Me këtë rast KSHC, bazuar në nenin 21 të UA për Akreditim, në mungesë të stafit akademik për këto katër programe të studimit, vendosi që ta tërheq / revokoi akreditimin e këtyre programeve.

Sipas nenin 21, pika 1 e UA për Akreditim (9/2017), thuhet se: "AKA e rezervon të drejtën të monitoroj dhe të kontrollojë cilësinë e institucioneve të akredituara në çfarëdo kohe me paralajmërim". Ndërsa sipas pikës 2 të nenit 26 të UA për Akreditim thuhet: "AKA mund të rishqyrtojë akreditimin e dhënë në çfarëdo kohe dhe/ apo më pas të tërheq vendimin e saj për akreditim nëse kushtet e dhëna me rastin e akreditimit janë shkelur". Bazuar në këtë çka u tha me sipër dhe në mungesë të stafit akademik për programet e cekura në pikat 1, 2, 3 dhe 4 të këtij vendimi, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqitet ankesë sipas nenit 125 dhe 126, të Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (tash e tutje LPPA) nr. 05/L-31, datë 25 maj 2016. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit i cili e ka nxjerr këtë vendim bazuar në nenit 128 të LPPA, në afatin prej 30 nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- BPrAL Kolegjit "Biznesi";
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.



Prof. Dr. Gazmend Luboteni
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë

